

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2118/ Prot.

Durrës, më 18.09.2025

VENDIM

Nr. 90, datë 18.09 2025

PËR

"NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 154, DATË 26.11.2018 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në Statutin e UAMD-së neni 15, pika 1 gërma (g); në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit administruar pranë UAMD-së me Nr. 1105/5 prot., datë 08.05.2025; në relacionin e Drejtorisë Juridike me Nr. 1105/7 prot., datë 11.09.2025, pas marrjes së mendimit të Bordit të Administrimit, në shkresën nr. 1105/8 prot., datë 18.09.2025, në mbledhjen e datës 18.09.2025 Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtesë në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 154, datë 26.11.2018 "Për miratimin e Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, si më poshtë:
 - Në Kreun V të Rregullores së UAMD-së "Personeli akademik dhe ndihmësakademik", Seksioni I "Personeli akademik", në nenin 109 "Kontributi i personelit akademik", të shtohet pika 13 "Akordimi i titullit "Profesor Emeritus" me procedurë:
 - a. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, ka të drejtën të akordojë titullin "Profesor Emeritus", për veprimtari të spikatur në fushën akademike dhe të shkencës.
 - b. Numri i titujve "Profesor Emeritus" që UAMD mund të akordojë në vit, nuk mund të jetë më shumë se 1 (një) për çdo njësi bazë.
 - c. Titulli "Profesor Emeritus" i jepet personelit akademik të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, i cili:
 - Ka mbushur moshën e pensionit;
 - Mban titullin akademik "Profesor";
 - Ka qenë personel akademik me kohë të plotë pranë Njesisë Bazë në të cilën ka ushtruar veprimtarinë e tij akademike, për të paktën 15 vjet.
 - d. Propozimi për dhënien e titullit "Profesor Emeritus" së bashku me relacionin e argumentuar mbi veprimtarinë e kandidatit për këtë titull, i paraqitet nga Njësia Bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij akademike, Drejtuesit të Njesisë Kryesore, i

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

- cili ja përcjell Rektorit për të drejtuar kërkesën pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.*
- e. *Ky titull jepet me vendim të Senatit Akademik të UAMD, pasi është marë pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin. Propozimi për dhënien e titullit "Profesor Emeritus" sëbashku me relacionin e argumentuar mbi veprimtarinë e kandidatit për këtë titull, paraqitet nga Njësia Bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij akademike, drejtuar Drejtuesit të Njesisë Kryesore përkatëse i cili ja përcjell atë Rektorit të UAMD-së për të drejtuar kërkesën pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.*
- f. *Akordimi i titullit akademik "Profesor Emeritus" bëhet në formë ceremoniale.*
2. Ky vendim i bashkëlidhet Vendimit të Senatit Akademik Nr. 154, datë 26.11.2018.
3. Rregullorja aktuale të përditësohet sipas pikës 1(një) të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
- Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtuesit e Njësive Bazë
 - Drejtorët e Drejtorive
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

